



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 82, Datë 20.04.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI
ENERGY TRADE” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 562/5 prot., datë 15.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 275 prot., datë 17.02.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar”, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar

dhe fiskal dhe Dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjise elektrike, Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “c”. **Plotësuar.**

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2:

- **gërmat “a”/“b”** (akti i themelimit/statuti)
Shoqëria duhet të depozitojë Statutin sipas kërkesës së nenit 8, pika 3 (në fotokopje të noterizuar ose origjinal).
- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet sipas kësaj kërkesë të rregullores.
- **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8:

- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria duhet të përcaktojë vlerën që do të vejë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria do të njoftohet që t’i përcjellë brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI